

## **RELACION**

### **PËR PROJEKLIGJIN**

#### **“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 55/2015, “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, I NDRYSHUAR**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji, është miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 55/2015, “*Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. Me anën e këtij ndryshimi synohet të shtohen përcaktimet e reja sa i përket llojeve të vendimmarrjes së Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), ndryshohet destinacioni i të ardhurave nga aplikimet për status duke kaluar në favor të buxhetit të agjencisë, shtohet nociioni i ndjekjes së planit të veprimit të projekteve të miratuara sipas vendimeve të KIS, ndryshohet dispozita e vënies në dispozicion të bregut të detit, i cili do të miratohet me Vendim të KIS pas vënies në funksion të strukturave turistike, përforcohen dispozitat që lidhen me detyrimet e investitorit strategjikë pas vendimmarrjes së KIS, si dhe të zgjatet afati i paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, deri më datën 31 dhjetor 2026 si dhe bëhen rregullime në dispozitën kalimtare.

Objektivat e këtij projektvendimi janë në përputhje të plotë me Programin e Qeverisë “Për nxitjen dhe Përmirësimin e Klimës së Biznesit” dhe gjithashtu me Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për periudhën 2021-2027.

Objektivat që synohet të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- **Tërheqja dhe mbështetja e investimeve strategjike;**
- **Mbështetje për investitorët vendas dhe të huaj si dhe lehtësimin e ndjekjes së procedurave për investimet strategjike;**
- **Promovimi i investimeve të synuara dhe realizuara në kuadër të legjispcionit të investimeve strategjike;**
- **Mundësi aplikimi në të gjithë sektorët e ekonomisë vendase pa kufizime sektoriale;**
- **Vlerësim objektiv referuar vlerës së investimit për tu kualifikuar si investitor strategjik.**

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji i mësipërm është në përputhje të plotë me programin e Qeverisë “Për nxitjen dhe Përmirësimin e Klimës së Biznesit” dhe Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për periudhën 2021-2027.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Me anën e këtij ndryshimi synohet; të shtohen përcaktimet e reja sa i përket llojeve të vendimmarjes së Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), të ndryshohet destinacioni i të ardhurave nga aplikimet për status duke kaluar në favor të buxhetit të agjencisë, shtohet nocioni i ndjekjes të projekteve të miratuar sipas planit të veprimit të projekteve të miratuar sipas vendimeve të KIS, ndryshohet dispozita e vënies në dispozicion të bregut të detit, i cili do të miratohet me Vendim të KIS pas vënies në funksion të strukturave turistike, zgjatet afati i paraqitjes së kërkesave nga subjektit investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimini e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, deri më datën 31 dhjetor 2026, si dhe bëhen rregullime në dispozitën kalimtare.

Paketa e plotë ligjore, ligj Nr. 55/2015 dhe 10 VKM në zbatim të tij, e cila u hartua në vitin 2015, u konceptua si një paketë ligjore pilot, me qëllim që t'i jepte një nxitje të mëtejshme projekteve të investimit në sektorët e cilësuar strategjikë sipas këtij ligji. Eksperiencia dëshmoi se interesi i subjekteve ishte shumë i lartë për këtë paketë ligjore dhe masave mbështetëse që ajo ofron, ndaj nga viti 2018 e deri aktualisht, kësaj pakete ligjore i është shtyrë afati i paraqitjes së aplikimeve të reja çdo vit. Nga ana tjetër, kjo paketë i ka shërbyer edhe vetë institucioneve të përfshira në vlerësimin e projekteve pasi ndjekja e proceseve të investimeve tashmë gjzon një ekspericencë 8 vjeçare dhe në këto vite është krijuar një rrjet komunikimi mes institucioneve në nivel teknik dhe nivel vendimmarrës.

Nga viti 2016 e deri tani janë trajtuar 108 projekte investimi, prej të cilave:

- 48 kanë përfituar status strategjik
- 30 projekte janë refuzuar
- 31 projekte janë në fazë vlerësimi

Duke qenë se interesi i subjekteve është ende shumë i lartë për këtë paketë ligjore, fluksi dhe stoku i investimeve të huaja në vend janë në shifrat më të larta krahasuar me 10-vjeçarin e fundit dhe me qëllim shmangien e krijimit të këtij boshllëku ligjor si dhe të pasojave që mund të krijohen prej tij, është menduar zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave deri më datën 31 dhjetor 2026.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji i propozuar është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe propozohet me qëllim plotësimin e kuadrit ligor për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin me Acquis Communautaire.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKIT

Ky projektligj është konceptuar në 14 dispozita duke parashikuar rregullime specifike për secilën dispozitë dhe konkretisht:

1. Në nenin 1 të projektligjit propozohen ndryshime lidhur me përkufizimet e nenit 3 të ligjit në fuqi, konkretisht:
  - riformulohet pika 8 sipas së cilës “Konsolidimi i tokës” është tërësia e masave me qëllim saktësimin hartografik, ripërshtatjen apo ristrukturimin e planifikuar të pronës, qartësimin e statusit të pronësisë, përfundimin me prioritet të proceseve kalimtare dhe atyre të posaçme të pronësisë, dhe çdo masë tjetër që mundëson gjëzimin, ndryshimin e destinacionit të përdorimit dhe shfrytëzimit të tokës në çdo kombinim.”
  - Poshtë pikës 8 shtohet një pikë tjetër “Verifikimi Kadastral” si më poshtë:
    - “*Verifikimi Kadastral*” është tërësia e verifikimeve të kryera në bashkëpunim me organet e qeverisjes qëndrore dhe vendore me qëllim marrjen e informacionit lidhur me pasuritë e paluajtshme të propozuara për zhvillim, si dhe përdorimin aktual ose të planifikuar të tyre. Ky verifikim përfshin pa u kufizuar në evidentimin nëse këto pasuri janë objekt i procedurave administrative të kthimit ose kompensimit të pronës; objekt i një procesi gjyqësor për titullin e pronësisë; objekt i procedurave administrative të legalizimit; objekt brenda rrjetit të zonave të mbrojtura; objekt me status “monument kulture”, “zonë historike” dhe sipërsfaqe me status “zonë arkeologjike” etj.
2. Në nenin 2 të projektligjit, propozohen ndryshime të nenit 6 të ligjit në fuqi, duke u shtuar pika 2/1 si më poshtë:

“Portofoli i investimeve për promovim nga ana e Agjencisë përbëhet nga:

- Planet 3 (tre) vjeçare të strategjisë të zhvillimit të investimeve, sipas fushave të përgjegjësisë të secilës ministri, si dhe kalendar 1 (një) vjeçar i projekteve të investimit për të cilat ministritë janë iniciatore/ propozuese apo përgjegjëse dhe projektifisha përkatëse për projekte sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ky portofoli investimi, për çdo fushë përgjegjësie, depozitohet çdo fillim viti kalendarik, fillimisht tek ministria përgjegjëse për ekonominë dhe pas vlerësimit nga kjo e fundit depozitohet tek Agjencia, me qëllim promovimin e këtyre investimeve tek investitorët e huaj dhe vendas.
  - Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike.
3. Në nenin 3 të projektligjit, shtohet poshtë pikës 5 të nenit 8 të ligjit në fuqi si më poshtë:

*“Statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” e përfitojnë gjithashtu investitorët/projektet investuese, për të cilat, pavarësisht se nuk janë parashikuar të realizohen në një nga sektorët e përcaktuara në pikën 1, të këtij nenit, parashikohet që vlerën totale të kapitalit investues të projektit ta kenë të barabartë ose më të madhe se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro dhe pasi të kenë marrë miratimin paraprak të ministrisë së linjës”.*

4. Në nenin 4 të projektligjit, përcaktohen ndryshime që pëson nenit 10, konkretisht:
  - Pas pikës 6, shtohet pika 6/1 e cila përcakton se: *Agjencia ndjek zbatimin e vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike*, përmes planit të veprimit të miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) bazuar në parashikimet e legjisacioneve sektoriale. . .
  - Shtohet pika 9 përmes të cilës përcaktohet se AIDA në përpunje me ligjin organik, ofron shërbime dhe realizon të ardhura dhe këto të fundit, në masën 30 % të kalojnë në Buxhetin e shtetit dhe 70% në të ardhurat e agjencisë. Këto të fundit do të përdoren nga AIDA, për qëllime promovimi përfundit të tjerëve e investimeve të huaja në Shqipëri.
5. Neni 5 i projektligjit, propozon shtime lidhur me deklarimet financiare të rrreme dhe shërbimeve e detyrimeve tatimore; mashtrimi, konflikti i interesit si dhe mosdeklarimi i pronarëve përfitues fundorë në përpunje me legjisacionin përfundit publike.
6. Neni 6 i projektligjit, propozon ndryshime të nenit 17, konkretisht:
7. Përpara pikës 1 shtohet pika1, si më poshtë:
  8. *“1. Agjencia kryen procesin e verifikimit kadastral të gjurmës së propozuar. Në rast se pas këtij verifikimi rezulton se projekti është i mundshëm përfundit, subjekti investues vilon me procedurat e mëtejshme përfundit të dorëzimin e projektit të investimit të shoqëruar me dokumentacionin e plotë mbështetës ligjor, teknik dhe financiar”.*
  9. Neni 7, i projektligjit zgjeron rastet e vendimmarjes së KIS të parashikuara në nenin 19. Aktualisht ky nen, parashikon rastet e revokimit të vendimit përfundit dhënien e statusit investitor strategjik në rastet kur konstatohen të dhëna të pavërteta apo ndryshime të të dhënave të paraqitura në projektin investues. Së pari, termi “revokim”, nuk trajtohet në Kodin e Procedurave Administrative. Po kështu, nenit 19, nuk trajton rastet të tjera shkeljesh nga investitori pas miratimit të statusit si investitor strategjik, si: “tejkalim të afateve përfundit të revokimit” ose “mospërfundit të detyrimeve”, të cilat sipas rastit mund të shkaktojnë një dëm mjedisor apo pasuror. Ky boshllëk ligjor, është propozuar të rregullohet duke futur raste të reja vendimmarjeje nga ana e KIS, si: *“Pezullim i përkohshëm, shfuqizim dhe anullimitë vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike”*
  10. Neni 8 i projektligjit është riformulim, i nenit 20 si pasojë e ndryshimeve që pëson nenit 19, pas shtimit të rasteve të tjera të vendimmarjes nga ana e KIS. Po kështu, është shfuqizuar pika 1 e këtij neni, duke qenë se në asnjë dispozitë të këtij ligji, nuk parashikohen sanksione administrative përfundit të investitorin strategjik pas vendimmarjes së KIS, duke ja lënë këtë përgjegjësi secilës prej ministrive përgjegjëse.
  11. Neni 9 i projektligjit, propozon ndryshime të nenit 29 të ligjit aktual. Ky propozim sjell riformulim të pikës 1, sipas të cilës përdorimi i brigjeve të deteve, lumenjve dhe liqeneve, si stacione plazhi lejohet me vendim të KIS dhe jo të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, në pikat e tjera që shtohen, përcaktohet afati maksimal i përdorimit të këtyre brigjeve, kompetenca Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, përfundit të lidhur marrëveshjen përkatëse me investitorin, tarifa e përdorimit nga Këshilli Bashkiak, etj. Në cdo rast gjëzimi i përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve dhe lumenjve si stacione plazhi, fillon efektet pas vëties në funksion të strukturave akomoduese turistike.

12. Në nenin 10 të projektligjit, propozon ndryshime të nenit 36 të ligjit aktual duke shtyrë afatin e vlefshmërisë së këtij ligji deri në dhjetor të vitit 6
13. Neni 11 i projektligjit përmban rregulla për periudhën kalimtare sipas së cilës për aplikimet që janë duke u shqyrtuar, aplikohen përcaktimet e propozuara në nenin 10 të projektligjit që ndryshon nenin 29 në fuqi.
14. Neni 12 i projektligjit ngarkon institucionet përgjegjëse për ndryshimet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja e tij në fuqi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e cila vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 10 303, datë 15.07.2010 “Për themelimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve” si dhe të gjitha institucionet/entet përgjegjëse për investimin strategik.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.